



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 17.01.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eskavatori SHPK" për aktivitetin: <"Ndertimi i tregut të ri të qytetit" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9689-511 nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Eskavatori SHPK" e datës 17.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit <"Ndertimi i tregut të ri të qytetit" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9689-511 kundër *Njoftimit për kontratë të AK-së*, të datës 30.12.2019, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimi të KRPP-së.

1. Vertetohet *Njoftimi* i publikuar me datë: 30.12.2019 dhe Autoriteti Kontraktues vazhdon aktivitetin sipas të njejt;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Eskavatori SHPK" me datë 17.01.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me publikimin e aktivitetit të prokurimit me titull: < "Ndertimi i tregut të ri të qytetit" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9686-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 20.01.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

- Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar drejt me rastin e vendosjes së kriterëve në pikën 9.1&9.2 të FDT-së është i pa bazuar për arsye të cekura në vijim:
- Para vendosjes së kriterëve Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar me kujdes përmbajtjen e punimeve që janë parapare me projektin e Tregut të ri të Qytetit dhe ka konstatuar se pjesa dërmuese e punimeve të parapara i takojnë ndertimit të lartë: Pllakat specifike, elementet mikroubane-gjelberimi, uleset etj, punët e muratimit, fasada

strukturale, punet e axhystatorise dhe llamarines, dyshemeja e lokaleve, lysterja, izolimet, trupat ngrohës dhe tubacionet dhe punet termoteknike dhe dhe për këtë arsye është kërkuar që tenderuesit të ofrojnë deshmë për punime të tilla. Pra kërkesat e AK-së janë në harmoni me punimet e parapara me projekt dhe pjesë e ndertimit të ulet: betonimet dhe ujësjellesit e kanalizimit paraqesin një përqindje të vogël nga punimet e parapara dhe për këtë kërkesat tona kanë të bëjnë kryesisht me deshmite për ndërtim të lartë. Se ky veprim është korrekt dhe i ligjshëm ndaj jush tregon edhe fakti se ju jeni deshmitarë të shumë publikimeve tona që kanë të bëjnë me ndërtimin e ulet dhe në të gjitha ato kërkesat tona kanë pasë të bëjnë me deshmite për punë të ndërtimit të ulet e që nuk i ka kontestuar asnjë tenderues e as ju.


Pra nga teksti paraprak mund të konstatohet lehtë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me kërkesat e projektit dhe me përcaktimet ligjore lidhur me aftësitë teknike të tenderuesëve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si në dispozitiv dhe Autoriteti Kontraktues vazhdon procedurën sipas Njoftimit të datës 30.12.2019.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese (nëpërmes Platformes elektronike);
- Njësisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit; dhe
- Anëtarëve të komisionit